

ANIO OIL & GAS sh.a

PASQYRAT FINANCIARE

31 Dhjetor 2017

ANIO OIL & GAS sh.a

31 Dhjetor 2017

Përmbajtja

| | <u>Faqe</u> |
|---|-------------|
| Raporti i Auditimit | 3 |
| Pasqyrat Financiare | |
| Pasqyra e pozicionit financiar (bilancit) | 5 |
| Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse | 6 |
| Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare | 7 |
| Pasqyra e ndryshimeve në kapitalet e veta | 8 |
| Shënime për pasqyrat financiare | 9-12 |

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

Drejtuar aksionerve edhe drejtuesve të shoqërisë: ANIO OIL & GAS sh.a

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë ANIO OIL & GAS sh.a, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë në datën 31 Dhjetor 2017, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Nderkombetare të auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuideojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.



Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu;

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brëndëshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendëshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionin mbi efikasitetin e kontrollit të brendëshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me Drejtimin Shoqërisë përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë
Datë, 26.06.2018

UHY Elite sh.p.k
Audituesit Ligjor



ANIO OIL & GAS sh.a

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)

në datën 31 Dhjetor 2017

(në LEK)

| AKTIVET | | 31 Dhjetor 2017 | 31 Dhjetor 2016 |
|--|----|--------------------|-------------------|
| Aktive afatshkurtër | | | |
| Aktive monetare | 2 | 10,486,968 | 24,620,762 |
| Të arkëtueshme nga aktiviteti shfrytëzimit | 3 | 1,801,487 | - |
| Aktive të tjera afat shkurtër | 4 | 25,634,891 | 47,689,930 |
| | | 37,923,346 | 72,310,692 |
| Aktive afatgjatë | | | |
| Koncensione, patenta dhe licensa | 5 | 78,247,836 | - |
| Kapital i nënshkruar i papaguar | 5 | 2,625,000 | 2,625,000 |
| | | 80,872,836 | 2,625,000 |
| | | 118,796,182 | 74,935,692 |
| DETYRIMET DHE KAPITALI | | | |
| Detyrime afatshkurtër | | | |
| Të pagueshme nga aktiviteti shfrytëzimit | 6 | 104,749 | 106,156 |
| Detyrime ndaj institucioneve tatimore | 7 | 1,610,741 | - |
| Detyrime ndaj punonjësve | 8 | 967,410 | 647,730 |
| | | 2,682,900 | 753,886 |
| Detyrime afatgjata | | | |
| Titujt e huamarrjes | 9 | 103,506,752 | 73,152,370 |
| | | 103,506,752 | 73,152,370 |
| Totali i detyrimeve | | 106,189,652 | 73,906,256 |
| KAPITALI I AKSIONEREVE | | | |
| Kapitali aksioner | 10 | 3,500,000 | 3,500,000 |
| Rezerva ligjore | 10 | - | - |
| Fitim i pashpërndarë | 10 | (2,470,564) | (1,019,125) |
| Fitim i vitit financiar | 10 | 11,577,094 | (1,451,439) |
| Totali i kapitalit të aksionerëve | | 12,606,530 | 1,029,436 |
| | | 118,796,182 | 74,935,692 |

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 9-12 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtuesit e ANIO OIL & GAS sh.a më datë 29.03.2018 dhe janë firmosur nga:

Alban PEZA

Administrator

ANIO OIL & GAS sh.a

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

për periudhën e mbyllur në 31 Dhjetor 2017

(në LEK)

| | | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|---|----|------------------------|------------------------|
| Të ardhurat | | | |
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 11 | 22,596,257 | - |
| | | 22,596,257 | - |
| Shpenzimet për aktivitetin kryesor | 12 | | |
| Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | | (8,968,960) | - |
| Paga dhe shpërblime | | (360,000) | (360,000) |
| Shpenzime për sigurime shoqërore | | (60,120) | (60,120) |
| Shpenzime të tjera shfrytëzimi | | (334,909) | (1,070,248) |
| | | (9,723,989) | (1,490,368) |
| Rezultati nga aktiviteti kryesor | | 12,872,268 | (1,490,368) |
| Të ardhura/shpenzime për interesa | 13 | 335,566 | (13,178) |
| Të ardhura/shpenzime të tjera financiare | 13 | - | 52,107 |
| | | 335,566 | 38,929 |
| Fitimi përpara tatimit | | 13,207,834 | (1,451,439) |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | | (1,630,740) | - |
| Fitimi neto i vitit | | 11,577,094 | (1,451,439) |
| PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE | | | |
| Fitimi neto i vitit | | 11,577,094 | (1,451,439) |
| Diferenca konvertimi nga operacionet jashtë njesisë | | - | - |
| Rivlerësime të pasurive të palujtshme | | - | - |
| Tatim mbi të ardhurat gjithpërfshirëse | | - | - |
| Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për pronarët e njësisë ekonomike mëmë | | 11,577,094 | (1,451,439) |

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 9-12 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ANIO OIL & GAS sh.a

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

për periudhën e mbyllur në 31 Dhjetor 2017

(në LEK)

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|--|------------------------|------------------------|
| Fluksi mjeteve monetare nga aktiviteti shfrytëzimit | | |
| Fitimi i vitit | <u>11,577,094</u> | <u>(1,451,439)</u> |
| Ndryshime ne kapitalin qarkullues | | |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme | 20,253,552 | (47,600,511) |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | 1,609,334 | 94,681 |
| Rritje/(rënie) në detyrimet ndaj punonjësve | 319,680 | 311,310 |
| | <u>33,759,660</u> | <u>(48,645,959)</u> |
| Fluksi mjeteve monetare nga aktiviteti investues | | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | <u>(78,247,836)</u> | - |
| | <u>(78,247,836)</u> | - |
| Fluksi mjeteve monetare nga aktiviteti financues | | |
| Hua të arkëtuara | 30,354,382 | 73,152,370 |
| Interes i paguar | - | - |
| Dividentë të paguar | - | - |
| | <u>30,354,382</u> | <u>73,152,370</u> |
| Rritje/(rënie) neto në mjete monetare | (14,133,794) | 24,506,411 |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë në fillim | <u>24,620,762</u> | <u>114,351</u> |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund | <u>10,486,968</u> | <u>24,620,762</u> |

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet lexuar ne lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 9-12 te cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ANIO OIL & GAS sh.a

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA për periudhën e mbyllur në 31 Dhjetor 2017 (ne LEK)

| | Kapital | Rezerva Ligjore | Rezerva të tjera | Fitimi i mbartur | Totali |
|--|------------------|------------------------|-------------------------|-------------------------|--------------------|
| Balanca në 31 Dhjetor 2015 | 3,500,000 | 0 | 0 | (1,019,125) | 2,480,875 |
| Fitim për vitin 2016 | 0 | 0 | 0 | (1,451,439) | (1,451,439) |
| Të tjera të ardhura gjithpërfshirëse | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse | 0 | 0 | 0 | (1,451,439) | (1,451,439) |
| Kontribute / shpërndarje tek aksionerët | | | | | |
| Divident të paguar aksionerëve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Krijimi dhe (përdorimi) i rezervave | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Emetimi i kapitalit të nënshkruar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i kontributive dhe shpërndarjes për aksionerët | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i ndryshimeve në zotërimin e aksioneve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i transaksioneve me aksionerët | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Balanca ne 31 Dhjetor 2016 | 3,500,000 | 0 | 0 | (2,470,564) | 1,029,436 |
| Fitim për vitin 2017 | 0 | 0 | 0 | 11,577,094 | 11,577,094 |
| Të tjera të ardhura gjithpërfshirëse | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse | 0 | 0 | 0 | 11,577,094 | 11,577,094 |
| Kontribute / shpërndarje tek aksionerët | | | | | |
| Divident të paguar aksionerëve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Krijimi dhe (përdorimi) i rezervave | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i kontributive dhe shpërndarjes për aksionerët | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i ndryshimeve në zotërimin e aksioneve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i transaksioneve me aksionerët | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Balanca ne 31 Dhjetor 2017 | 3,500,000 | 0 | 0 | 9,106,530 | 12,606,530 |

ANIO OIL & GAS sh.a

Shënime për Pasqyrat Financiare 31 Dhjetor 2017

(shumat të shprehura në Lek)

1. Përmbledhje e politikave të përgjithshme kontabël

(a) Natyra e aktivitetit

Shoqëria ANIO OIL & GAS sh.a është rregjistruar në datën 16/10/2014 me NIPT: L42223008U me aktivitet kryesor tregtinë në industrinë e hidrokarbureve. Shoqëria e ka selinë në adresën: Rr “Ndre Mjeda”, Tiranë.

(b) Stadartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK)

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe të Ligjit Nr. 9228 date 29.04.2004 “Mbi kontabilitetin dhe mbajtjen e pasqyrave financiare”.

(c) Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike, përjashtuar derivativët financiar (n.q.s ka), instrumentat financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit e humbjes dhe aktivet financiare të vlefshme për shitje, të cilat maten me vlerë të drejtë.

(d) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në LEK e cila është monedha funksionale e kompanisë.

(e) Përdorimi i gjykimeve dhe hamendësimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare konform SKK-ve, kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht.

(f) Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhat e huaja janë përkthyer me kursin e kembimit të datës së transaksionit. Aktivet monetare në monedha të huaja janë përkthyer në monedhen raportuese me kursin në ditën e mbylljes së bilancit. Diferencat e konvertimit si pasojë e përkthimit të monedhave të huaja në monedhën raportuese janë përfshirë në fitim humbje të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj vlerësuar me koston historike, janë raportuar me kursin historik të monedhës së huaj në datën e transaksionit.

(g) Inventarët

Shoqëria ka vlerësuar gjendjet e inventarit në datën e mbylljes së bilancit duke përdorur metodën e më të vogël midis koston së blerjes dhe vlerës neto të realizueshme.

(h) Llogaritë për tu arkëtuar (klientët)

Shoqëria ka bërë vlerësimin e mbledhshmërisë së llogarive për tu arkëtuar dhe i ka paraqitur ato në pasqyrën e bilancit me vlerën e drejte.

(i) Aktivët afatgjatë

Aktivët afatgjatë janë pasqyruar me metodën e koston historike, kurse amortizimi vjetor është llogaritur sipas metodave të mëposhtme:

| Emërtimi | Metoda e amortizimit | Norma vjetore |
|------------------------|----------------------|---------------|
| Ndërtesa | Mbi vlerën e mbetur | 5% |
| Makineri | Mbi vlerën e mbetur | 20% |
| Mjete Transporti | Mbi vlerën e mbetur | 20% |
| Pajisje zyre (mobilje) | Mbi vlerën e mbetur | 20% |
| Pajisje Elektronike | Mbi vlerën e mbetur | 25% |

ANIO OIL & GAS sh.a

Shënime për Pasqyrat Financiare 31 Dhjetor 2017

(shumat të shprehura në Lek)

1. Përmbledhje e politikave të përgjithshme kontabël (vazhdon)

(j) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë bankare, dhe përfitimet nga diferencat e këmbimit. Interesat njihen ashtu siç përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesa dhe humbjet nga diferencat e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

2. Aktive monetare

Mjetet monetare të shoqërisë janë të përbëra nga likuiditete në arkë dhe në bankë. Të gjitha mjetet monetare në monedhë të huaj janë rivlerësuar me kursin zyrtar të fundit të vitit sipas Bankës së Shqipërisë dhe diferencat përkatëse kanë kaluar në fitim ose humbje nga rivlerësimi i monedhave të huaja.

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|-------|------------------------|------------------------|
| Banka | 10,453,701 | 24,587,495 |
| Arka | 33,267 | 33,267 |
| | <u>10,486,968</u> | <u>24,620,762</u> |

3. Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Teprica përfaqëson shumën e klienteve në datën e mbylljes së bilancit të cilat janë për tu arkëtuar në periudha të mëvonshme.

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|---------|------------------------|------------------------|
| Klientë | <u>1,801,487</u> | <u>-</u> |

4. Aktive të tjera afatshkurtër

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|----------|------------------------|------------------------|
| Të tjera | 25,634,891 | 47,600,511 |
| Tatimore | - | 89,419 |
| | <u>25,634,891</u> | <u>47,689,930</u> |

5. Aktive afatgjatë

Aktive afatgjatë përbëhen nga:

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|----------------------------------|------------------------|------------------------|
| Koncensione, licensa dhe patenta | 78,247,836 | - |
| Kapital i nënshkruar i papaguar | 2,625,000 | 2,625,000 |
| | <u>80,872,836</u> | <u>2,625,000</u> |

6. Të pagueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Detyrimet e shoqërisë kundrejt furnitorëve janë vlerësuar si detyrime afatshkurtër dhe si të tilla janë për tu paguar brenda ciklit të ardhshëm. Ato përfaqësojnë shumën e llogarive individuale të furnitorëve të ndryshëm.

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|-----------|------------------------|------------------------|
| Furnitorë | <u>104,749</u> | <u>106,156</u> |

ANIO OIL & GAS sh.a

Shënime për Pasqyrat Financiare 31 Dhjetor 2017

(shumat të shprehura në Lek)

7. Detyrime ndaj institucioneve tatimore

Detyrimet ndaj organizmave shtetërorë si më poshtë, përfaqësojnë detyrimet që i përkasin muajit Dhjetor të cilat do të paguhen në fillim të vitit të ardhshëm.

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|---------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Detyrime ndaj institucioneve tatimore | <u>1,610,741</u> | <u>-</u> |

8. Detyrime ndaj punonjësve

Detyrimet ndaj punonjësve si më poshtë, përfaqësojnë detyrimet që i përkasin muajit Dhjetor si paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore, të cilat do të paguhen në fillim të vitit të ardhshëm.

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|--------------------------|------------------------|------------------------|
| Detyrime ndaj punonjësve | <u>967,410</u> | <u>647,730</u> |

9. Detyrime afatgjata

Detyrimet afatgjata përfaqësojnë titujt afatgjatë të huamarrjes si mëposhtë:

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|---------------------|------------------------|------------------------|
| Titujt e huamarrjes | <u>103,506,752</u> | <u>73,152,370</u> |

10. Kapitali

Kapitalet e veta përbëhen nga:

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|-------------------------|------------------------|------------------------|
| Kapital aksioner | 3,500,000 | 3,500,000 |
| Rezerva ligjore | - | - |
| Fitimi i pashpërndarë | (2,470,564) | (1,019,125) |
| Fitim i vitit ushtrimor | 11,577,094 | (1,451,439) |
| | <u>12,606,530</u> | <u>1,029,436</u> |

11. Të ardhurat

Shoqëria realizon të ardhura kryesisht nga tregtia në industrinë e hidrokarbureve.

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|--|------------------------|------------------------|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | <u>22,596,257</u> | <u>-</u> |

ANIO OIL & GAS sh.a

Shënime për Pasqyrat Financiare 31 Dhjetor 2017

(shumat të shprehura në Lek)

12. Shpenzimet për aktivitetin kryesor

Shpenzimet e aktivitetit paraqiten si më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|----------------------------------|------------------------|------------------------|
| Lënda e parë dhe materiale | 8,968,960 | - |
| Paga dhe shpërblime | 360,000 | 360,000 |
| Shpenzime për sigurime shoqërore | 60,120 | 60,120 |
| Shpenzime të tjera shfrytëzimi | 334,909 | 1,070,248 |
| | <u>9,723,989</u> | <u>1,490,368</u> |

13. Të ardhura dhe shpenzime financiare

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|--------------------------------|------------------------|------------------------|
| Të ardhura neto nga interesi | 335,566 | (13,178) |
| Të tjera të ardhura financiare | - | 52,107 |
| | <u>335,566</u> | <u>38,929</u> |

14. Rezultati tatimor

| | <u>31 Dhjetor 2017</u> | <u>31 Dhjetor 2016</u> |
|-----------------------------------|------------------------|------------------------|
| Fitimi neto para tatimit | 13,207,834 | (1,451,439) |
| Gjoha penalitete | - | - |
| Prime të sigurimit | - | - |
| Shpenzime të pazbritshme | - | - |
| Humbje e panjohur fiskalisht 2014 | (89,704) | |
| Humbje e panjohur fiskalisht 2014 | (817,303) | |
| Humbje e panjohur fiskalisht 2014 | (1,429,223) | |
| Fitimi para tatimit | 10,871,604 | |
| Shpenzim tatim fitimi | (1,630,741) | |
| Fitim/Humbje për periudhën | <u>11,577,094</u> | <u>(1,451,439)</u> |